



## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – SUHAREKË

Nr. Protokollit	02/ 2024
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	16.04.2024

### PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

#### Në takim morën pjesë :

**Afrim Sylaj** - Komandant në Stacionin Policor në Therandë  
**Halim Shehu** - përfaqësues i Komunitetit Islam  
**Albert Demaj** - përfaqësues i Komunitetit Katolik  
**Enver Shabani** - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë  
**Fetije Bytyqi** - përfaqësuese e EVSB-së  
**Remzi Bajselmani** - Drejtor i Drejtorisë së arsimit  
**Habibe Bytyqi** - Zyrtare për barazi gjinore  
**Albestrim Rexhepi** - përfaqësues i FSK-së  
**Drilon Zyba** - përfaqësues i KLSP-së  
**Adem Derguti** - Kryetar i KPAK-së  
**Rozeta Jahaj** - përfaqësuese e OJQ-ë  
**Refki Zogaj** – përfaqësues i komunitetit të biznesit  
**Eurolinda Zenelaj** - përfaqësuese e mediave lokale  
**Xheladin Sadikaj** - përfaqësues i zyrës KKK-së  
**Qëndresa Baftjaraj** - përfaqësuese e KPAK-së  
**Myrvete Shala** - përfaqësuese e Shqiptarëve  
**Denis Sofra** - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li  
**Zekë Berisha** - përfaqësues i Romëve  
**Nazim Shabanaj** - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj i cila i njoftoi me rendin e ditës.

### **Rend dite**

- 1. Miratimi Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**
- 3. Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**
- 4. Mbështetja e projekteve konkrete në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi dhe komunitetit;**
- 5. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

**Kryetari** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryetari** - e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet Pika 1**

**Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**

**Afrim Sylaj** - sa i përket situatës së sigurisë në komunën e Suharekës është një situatë e qetë dhe stabile bazuar në raportin tremujor.Sa i përket incidenteve kemi 16 incidente më pak se tremujorin e kaluar.Sa i përket sigurisë në trafik nuk kemi asnjë rast me aksident me fatalitet,kemi rënie të aksidenteve me lëndime dhe kemi më pak aksidente me dëme materiale.Sa i përket raportimit gjatë tremujorit të parë nuk kemi pas asnjë vrasje të raportuar,nuk kemi pas asnjë grabitje si raste më kapitale.Vepra penale të kanosjeve nga 11 raste,tani kemi 9 raste apo 18 % më pak; vjedhje nga 14 raste që kemi pas,tani kemi 9 apo -35%; vjedhje të rënda të shtëpive nga 12 raste,tani kemi 18 raste; raste të dhunës në familje nga 18 raste tani kemi 13 raste ose -27%; aksident me lëndime të rënda nga 2 raste ,tani kemi 1 rast; aksidente me dëme material nga 52 ,tani kemi 51 raste; urdhëresa të realizuara nga 216,tani kemi 164 urdhëresa të gjykatës; tiketa në trafik nga 2976,tani kemi shqiptu 3055.Policia e Kosovës ka mbajtur ligjerata nëpër shkolla me temën dhuna në familjet sipas rekomandimit të DKA-së.

**Habibe Bytyqi** - dua të di që prej 13 rasteve që i kemi në këtë tremujor a janë të gjitha femra apo ka edhe të gjinisë mashkullore?

**Afrim Sylaj** - kemi viktime edhe të gjinisë mashkullore të moshës së shtyrë mirëpo 90% e rasteve janë femra.Shumica e rasteve janë raste recidiviste.

**Rekomandim:** të vazhdojë bashkëpunimi mes organeve të policisë,qytetarëve dhe institucioneve përgjegjëse që janë për çështje të sigurisë.

**Kryetari** - e hedh në votim rekomandimin.

**Aprovohet rekomandimi**

**Pika 3. Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**

**Avni Bytyqi** - në kuadër të planit të punës së KKSBB, nga FSK-ja ka qenë kërkesë që të jetë kjo pikë e rendit të ditës që të mbajnë ligjerata për çështjen e vetëdijësimit të nxënësve për mjetet e pa shpërthyer pas luftës në Kosovë dhe në kuadër të KKSBB-së do ta trajtojmë këtë çështje dhe në fund do të dalim me rekomandime. Mund të them që vazhdimisht komuna jonë ka mbajtur ligjerata nëpër shkollat aty ku e ka pa të arsyeshme dhe të domosdoshme për çështjen e mjeteve të pa shpërthyer.

**Afrim Sylaj** - nuk është me rëndësi vetëm rreziku nga minat. Është mirë të futet edhe rreziku nga mjetet të ndryshme piroteknike në mënyrë që të mos kemi lëndime në festat e fundvitit.

**Kryetari** - në aspektin ligjor nuk kemi mundësi si komunë me i ndal por ne mund ti marrim disa masa brenda mundësive tona.

**Avni Bytyqi** - komandanti e ka me të drejtë dhe po thotë jo ti ndalojmë por të mbajmë ligjerata nëpër shkollat.

**Habibe Bytyqi** - e ceke që kemi fillu me bë vetëdijësim të tillë dhe pasi kemi praktika të mira ndoshta është mirë që si rekomandim të vazhdohet kjo.

**Rekomandim:** Drejtoria e Arsimit të bëjë kërkesë në ministrinë e FSK-së që ekspert të fushës së caktuar për çështjen e rrezikut të mjeteve të pa shpërthyer dhe mjeteve piroteknike që nxënësit tonë dhe qytetarët e komunës tonë po i përdorin në festa të ndryshme, të mbajnë ligjerata për këtë çështje.

**Kryetari** - e hedh në votim rekomandimin.

**Aprovohet rekomandimi**

**Pika 4. Mbështetja e projekteve konkrete në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi dhe komunitetit;**

**Avni Bytyqi** - ndoshta edhe shoqëria civile është mirë me ardhë me ndonjë projekt konkret për çështjen e sigurisë sidomos të vendosja e kamerave aty ku e planifikojnë që ka rrezik potencial. Mbledhjen e kaluar u dha një propozim nga Drilon Zyba dhe nga ky takim dol një rekomandim. Besoj që komuna ka me realizu.

**Rekomandim:** të vazhdohet me implementimin e projekteve që ofrohen nga akterët kryesor të sigurisë.

**Afrim Sylaj** - është mirë të rriten edhe projektet në ndriçimin e rrugëve në periferi me qëllim që të parandalohen veprat penale në bazë të rasteve të ndryshme, si ngacmime të femrave, vjedhjeve etj.

**Rekomandim:** çështja e vendosjes së ndriçimeve nëpër vendet publike.

**Kryetari** - i hedh në votim rekomandimet.

**Aprovohen rekomandimet**

**Pika 5. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

**Kryetari** - sa i përket kësaj pike ne kemi dal në qytet dhe i kemi pyet por asnjë nuk është i komunës së Suharekës. Ata vin nga Shqipëria dhe nga komunat tjera. Do të ishte mirë që si rekomandim të del që policia të bëjë sa më shumë kontroll dhe të bëjë identifikimin i tyre.

**Avni Bytyqi** - është njëri që del shpesh sidomos të martëve. Më intereson të dijë se nga është .

**Kryetari** - ai më duket është i Prishtinës. Tash jemi duke i trajtu qentë endacak dhe është mirë të mbyllet

problemi me atë që ka ardhë nga Shtimja apo Ferizaji që ecë me qentë endacak nëpër qytet. Ai vendbanim këtu nuk ka dhe nuk e di çka të bëjmë me të. Duhet ta pyesim edhe QPS-në se çka mund të bëjmë.

**Afrim Sylaj** - ai nuk është qytetar i komunës tonë por nuk ka bashkësi familjare dhe me këtë duhet të merret QPS-ja ose ti gjej një strehim adekuat por ne si polici nuk kemi kompetencë me strehu. Ai nuk është i rrezikshëm por rreziku është që qentë që shkojnë pas tij paraqesin rrezik dhe i kemi 3 raste.

**Avni Bytyqi** - u përmend që lëmshë-kërkuesit po vin nga Shqipëria dhe besoj komandant që është mirë ti identifikojmë ata persona që vin nga Shqipëria dhe duhet ti dërgojmë në gjykatë, ku gjykata i dëbon dhe ia ndalon hyrjen.

**Arim Sylaj** - ne kemi reagu në dy raste ku një person e kemi gjet në kombi dhe e kemi depërtu në Shqipëri. Këta vin më shumë në kohën kur ka festë ose ditë tregu dhe nuk janë banorë të Komunës së Suharekës. Ne do të veprojmë si polici sa herë i hasim dhe do të marrim masa.

**Rekomandim:** Policia të marrin masa të vazhdueshme për lëmshë-kërkuesit dhe në veqanti për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

**Kryetari** - e hedh në votim rekomandimin.

**Aprovohet rekomandimi**

Takimi përfundoi: 10:30

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj